



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 186

Tiranë – E hënë, 23 tetor 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 64, datë 16.10.2017	9203
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 65, datë 16.10.2017	9209



VENDIM
Nr. 64, datë 16.10.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i	Gjykatës Kushtetuese
Vitore Tusha	anëtare e	“ “
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“ “
Fatmir Hoxha	anëtar i	“ “
Besnik Imeraj	anëtar i	“ “
Fatos Lulo	anëtar i	“ “
Gani Dizdari	anëtar i	“ “

me sekretare Belma Lleshi, në datën 3.10.2017, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 41 akti që i përket:

KËRKUES: Eduard Banaj

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimeve nr. 669, datë 13.11.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, nr. 488, datë 7.7.2015, të Gjykatës së Apelit Vlorë, nr. 00-2016-2158, datë 9.12.2016, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Gani Dizdari, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit, që kërkoi pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, që kërkoi rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. 669, datë 13.11.2014, midis të tjerave, ka vendosur: “*Deklarimin fajtor të të pandehurit Eduard Banaj, për kryerjen e veprës penale të vjedhjes me pasojë vdekjen, të parashikuar nga neni 141 i Kodit Penal (KP) dhe dënimin e tij me burgim të përjeshëm.*”.

2. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 488, datë 7.7.2015, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit për kërkuarin.

3. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2016-2158, datë 9.12.2016, në dhomë këshillimi, ka vendosur: “*Mospranimin e rekursit të prokurorit, kërkuarit dhe të të pandehurve të tjerë në gjykim, pasi nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 432 i Kodit të Procedurës Penale (KPP).*”.

II

4. **Kërkuesi** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore të të tria shkallëve të gjykimit, duke pretenduar se ato janë rrjedhojë e një procesi jo të rregullt ligjor. Ai ka parashtruar, në mënyrë të përmbledhur, këto shkaqe:

4.1 Gjykatat kanë zbatuar keq nenin 152 të KPP-së lidhur me deklaratimet e të pandehurit A.C., duke i marrë të shkëputura nga provat e tjera.

4.2 Nuk është bërë ekzaminimi mbi vërtetësinë e përgjimeve ambientale, sipas urdhërimeve të KPP-së.

4.3 Kërkuesi është dënuar me një vendim të pabazuar në prova, por vetëm në deklaratimet e bëra nga të pandehurit e tjerë në gjykim. Për këtë arsye u kërkua edhe riçelja e hetimit gjyqësor, por nuk u pranua nga gjykata, gjë që cenon parimin e kontradiktoritetit të palëve në gjykim dhe prezumimin e pafajësisë së të pandehurit.

4.4 Vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë duhet të mbante qëndrim në shqyrtimin e pretendimeve të kërkuarit, kur nga ky i fundit janë pretenduar shkelje të së drejtës për një proces të rregullt ligjor nga gjykatat e faktit, si dhe shkaqe të parashikuara nga neni 432 i KPP-së dhe jo të vendoste moskalimin e çështjes për shqyrtim. Vendimi i atij Kolegji është i paarsyetuar dhe ka cenuar aksesin në gjykatë.

5. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka parashtruar se:

5.1 Nuk qëndron pretendimi se është cenuar parimi i barazisë dhe kontradiktoritetit. Kërkuesi ka marrë pjesë në gjykim dhe ka parashtruar kërkitime dhe pretendime të cilat kishin të bënin me marrjen e dëshmimeve të disa personave. Gjykatat, pasi i kanë vlerësuar kërkitimet, i kanë rrëzuar si të pabazuara në ligj. Kjo nuk e bën



procesin të parregullt, pasi një gjë e tillë është në kompetencë dhe vlerësim të gjykatave. Kërkuesi dhe avokati i tij kanë ushtruar të gjitha të drejtat procedurale që i njeh ligji.

5.2 Nuk qëndron as pretendimi për cenim të prezumimit të pafajësisë, pasi kërkuesi nuk ka sjellë asnjë fakt ose provë që gjykimi ndaj tij të ketë filluar me bindjen se ai është fajtor. Asnjë prove të administruar gjatë gjykimit nuk i është dhënë vlerë e paracaktuar, pra është vlerësuar vetëm gjatë gjykimit.

5.3 Nuk është i bazuar as pretendimi se vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është i paarsyetuar. Çështja është shqyrtuar në dhomën e këshillimit si filtër seleksionues dhe ai vendim i plotëson të gjitha standardet e arsytimit të vendimit në këtë fazë shqyrtimi, referuar edhe jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese për këtë qëllim.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

6. Kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, ai legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi pretendimet e tij janë paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, Gjykata ka theksuar se roli i saj nuk është të rivlerësojë faktet, zbatimin e ligjit material apo zgjidhjen e dhënë nga gjykatat e zakonshme. Kontrolli që ajo ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave. Interpretimi i ligjit, duke përcaktuar përmbajtjen e tij, është atribut i organeve që e zbatojnë atë dhe nisur nga ky parim sqarimi i kuptimit apo interpretimi i çdo dispozite ligjore të zbatueshme gjatë shqyrtimit të një çështjeje të caktuar është në kompetencë të gjykatave të sistemit të zakonshëm gjyqësor (*shih vendimet nr. 23, datë 17.5.2011; nr. 1, datë 20.1.2012; nr. 4, datë 5.2.2014, të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Duke qenë se pretendimet e kërkuesit janë të natyrës kushtetuese, Gjykata vlerëson se ai legjitimohet edhe *ratione materiae*, pasi nuk ka mjet tjetër efektiv për të vënë në vend të drejtën e pretenduar si të cenuar nga vendimet gjyqësore.

B. Për pretendimin e cenimit të procesit të rregullt nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë

8. Sipas kërkuesit, gjykatat kanë cenuar parimin e barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit, duke mospranuar kërkesën e tij për rimarrje të dëshmimeve dhe përsëritje të hetimit gjyqësor. Po kështu, kërkuesi ka pretenduar se këto pretendime janë ngritur edhe në rekursin në Gjykatën e Lartë, e cila nuk u ka dhënë përgjigje atyre, duke cenuar në këtë mënyrë të drejtën e aksesit në gjykatë dhe standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor.

9. Në nenin 42/2 të Kushtetutës parashikohet se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Kjo dispozitë sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t’i drejtohen një gjykate, e cila do t’i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t’i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Në rast se mohohet kjo e drejtë procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t’iu drejtuar gjykatës (*shih vendimet nr. 21, datë 20.3.2017; nr. 52, datë 14.11.2014, të Gjykatës Kushtetuese*).



10. Gjithashtu, Gjykata ka vlerësuar se neni 42 i Kushtetutës sanksionon në vetvete jo vetëm të drejtën e individit për t'iu drejtuar gjykatës, por edhe detyrimin e shtetit që t'ia garantojë atij këtë akses. Gjykata ka konsideruar se sipas këtij neni detyrimi për të garantuar të drejtën efektive të aksesit në gjykatë nuk nënkupton thjesht mungesën e një ndërhyrjeje, por mund të kërkojë edhe ndërmarrjen e veprimeve pozitive nga ana e shtetit. Në rast se mohohet një e drejtë e tillë, procesi konsiderohet jo i rregullt, sepse aksesit në gjykatë është para së gjithash një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës (*shih vendimet nr. 84, datë 30.12.2016; nr. 67, datë 17.11.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në këtë këndvështrim, Gjykata ka vlerësuar se Gjykata e Lartë, rast pas rasti, duhet t'u japë përgjigje problemeve ligjore, që në praktikë lidhen me interpretimin e ligjit. Sipas Gjykatës, në të tilla raste, kërkesit, duke mos marrë përgjigje për pretendimet e tij me natyrë kushtetuese, për shkak të vendimit të mospranimit të rekursit, i cenohet jo vetëm e drejta e aksesit, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, por edhe e drejta e ankimit në kuptimin substancial, e parashikuar në nenin 43 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 27, datë 27.3.2017; nr. 73, datë 16.12.2016; nr. 24, datë 25.4.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Gjykata është shprehur se përdorimi i mjetit procedural të përshtatshëm ankimes në formë e në përmbajtje, siç është sanksionuar në Kodin e Procedurës Penale, nuk përbën një kërkesë formale, por një kërkesë që lidhet me thelbin e së drejtës së mbrojtjes dhe të pjesëmarrjes aktive në gjykim. Mostrajtimi i mjetit procedural në mënyrë substanciale cenon të drejtën e mbrojtjes së të gjykuarit dhe njëkohësisht aksesin e tij në Gjykatën e Lartë (*shih vendimet nr. 84, datë 30.12.2016; nr. 21, datë 24.7.2006, të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Gjykata, në këtë drejtim, ka theksuar se është kompetencë e Kolegjit Civil/Penal (dhoma e këshillimit) të analizojë dhe vlerësojë nëse shkaqet e ngritura në rekurs janë në përputhje me kërkesat e ligjit. Megjithatë, ky standard nuk duhet kuptuar sikur i mundëson Gjykatës së

Lartë ushtrimin e kompetencës së mësipërme në mënyrë diskrecionale. Gjykata ka theksuar se standardet kushtetuese për një proces të rregullt ligjor duhen respektuar në të gjitha fazat e gjykimit, përfshirë këtu shqyrtimin e rekursit nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit. Rekursi është mjeti procedural në dispozicion të kërkesit, me anë të të cilit ai mund të ketë akses në Gjykatën e Lartë, duke e investuar këtë të fundit me shqyrtimin e pretendimeve të tij (*shih vendimet nr. 73, datë 16.12.2016; nr. 24, datë 25.4.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Referuar jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, Gjykata e Lartë, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë ligji, ka për detyrë të kontrollojë mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta (*shih vendimet nr. 84, datë 30.12.2016; nr. 14, datë 17.4.2007; nr. 35, datë 20.12.2005, të Gjykatës Kushtetuese*). Po ashtu, Gjykata, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, ka tashmë një qëndrim të konsoliduar, sipas të cilit kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Një linjë e tillë lidhur me raportin ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/1/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit) (*shih vendimet nr. 4, datë 28.2.2006; nr. 19, datë 2.4.2012; nr. 58, datë 24.12.2012; nr. 52, datë 2.12.2013; nr. 3, datë 23.1.2014; nr. 84, datë 30.12.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Për sa u takon vendimeve të dhëna nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit dhe referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, Gjykata ka theksuar se vetëm kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, vendimi i Kolegjit për mospranimin e rekursit vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 19, datë 19.7.2005; nr. 22, datë 6.6.2011; nr. 18, datë 14.4.2015; nr. 84, datë 30.12.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).



16. Gjykata ka vlerësuar, gjithashtu, se kontrolli i kushtetutshmërisë së një vendimi gjyqësor vlerësohet në një kontekst të caktuar faktesh që lidhen me të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Rastet që i paraqiten Gjykatës mbi bazën e ankimit të individëve, duhet të shqyrtohen domosdoshmërisht në bazë të provueshmërisë së fakteve të dhëna. Marrja e vendimit për çështje kushtetuese kushtëzohet nga përcaktimi i fakteve kushtetuese, mbi bazën e të cilave vlerësohet respektimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Përderisa Gjykata Kushtetuese ka autoritetin për të vendosur përfundimisht për çështje të kushtetutshmërisë së procesit gjyqësor, ajo nuk mund ta ushtrojë këtë kompetencë pa analizuar faktet e natyrës kushtetuese (*shih vendimin nr. 5, datë 2.3.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Duke iu rikthyer çështjes konkrete, Gjykata vëren se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit me argumentin se nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 432 i KPP-së. Po ashtu, Gjykata konstaton se kërkuesi, në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë, ka ngritur pretendime të natyrës kushtetuese. Konkretisht, kërkuesi ka pretenduar se gjykatat janë bazuar vetëm në disa dëshmi jobindëse të dëshmitarëve për ta deklaruar atë fajtor dhe nuk kanë pranuar të marrin prova të tjera thelbësore dhe bindëse të kërkuara prej tij. Gjithashtu, sipas kërkuesit, gjykatat nuk kanë pranuar të përsërisin përgjimin ambiental, i cili, sipas kërkuesit, është bërë në shkelje të rregullave procedurale për këtë qëllim, duke cenuar parimin e barazisë së armëve në gjykim. Më tej, në rekurs kërkuesi ka ngritur pretendimin për mosrespektim të parimit të prezumimit të pafajësisë, pasi gjykatat kanë pranuar dhe administruar çdo provë të paraqitur nga akuza pa ia shqyrtuar mirëfilltazi hetimit të mëtejshëm gjyqësor.

18. Gjykata, nisur nga sa më lart, arrin në përfundimin se pretendimet e paraqitura në rekursin e bërë në Gjykatën e Lartë kanë qenë të tilla që duhej të kishin marrë përgjigje nga Kolegji Penal i asaj gjykate. Vetëm në këtë mënyrë ai kolegji do të kishte arritur në një përfundim të drejtë për të gjitha pretendimet e natyrës kushtetuese të paraqitura nga kërkuesi, i cili do të kishte mundur të realizonte efektivisht të drejtën e aksesit në gjykatë.

19. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor nga ana e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, është i bazuar dhe duhet pranuar.

C. Për pretendimet e tjera

20. Për sa u takon pretendimeve të tjera të kërkuesit, që kanë të bëjnë me kontradiktoritetin në gjykim, cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë etj., Gjykata vlerëson të mos ndalet në analizimin e tyre, për sa kohë çështja do të merrret përsëri në shqyrtim nga Gjykata e Lartë, e cila në funksion të rolit të saj si gjykatë e ligjit dhe si kontrolluese e respektimit të standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta, duhet t'u japë përgjigje të arsyetuar pretendimeve të mësipërme të ngritura në rekurs.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 71 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës.
- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 00-2016-2158, datë 9.12.2016, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, vetëm për pjesën që i takon kërkuesit Eduard Banaj.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Besnik Imeraj, Fatmir Hoxha, Gani Dizdari, Fatos Lulo
Anëtarë kundër: Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha



MENDIM PAKICE

1. Në çështjen me kërkues Eduard Banaj jam kundër qëndrimit të shumicës për pranimin pjesërisht të kërkesës, duke shfuqizuar si të papajtueshëm me Kushtetutën vendimin nr. 00-2016-2158, datë 9.12.2016 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

2. Sipas shumicës, kërkuesi në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë ka ngritur pretendime të natyrës kushtetuese. Kërkuesi ka pretenduar se gjykatat janë bazuar vetëm në disa dëshmi jobindëse të dëshmitarëve për ta deklaruar atë fajtor dhe nuk kanë pranuar të marrin prova të tjera thelbësore dhe bindëse të kërkuara prej tij. Gjithashtu, sipas kërkuesit, gjykatat nuk kanë pranuar të përsërisin përgjimin ambiental, i cili është bërë në shkelje të rregullave procedurale për këtë qëllim, duke cenuar parimin e barazisë së armëve në gjykim. Më tej, në rekurs kërkuesi ka ngritur pretendimin për mosrespektim të parimit të prezumimit të pafajësisë, pasi gjykatat kanë pranuar dhe administruar çdo provë të paraqitur nga akuza pa ia shqyrtuar mirëfilltazi hetimit të mëtejshëm gjyqësor. Sipas Gjykatës, këto pretendime kanë qenë të tilla që duhej të kishin marrë përgjigje në seancë dhe me praninë e palëve nga Kolegji Penal i asaj gjykate. Vetëm në këtë mënyrë ai kolegji do të kishte arritur në një përfundim të drejtë për të gjitha pretendimet e natyrës kushtetuese të paraqitura nga kërkuesi, i cili do të kishte mundur të realizonte efektivisht të drejtën e aksesit në gjykatë.

3. Në linjë me qëndrimet e mia në pakicë në çështje të së njëjtës natyrë, edhe në rastin konkret dua të ritheksoj se sipas nenit 433 të KPP-së është në kompetencë të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) të analizojë dhe të vlerësojë nëse shkaqet e ngritura në rekurs janë në përputhje me kërkesat e ligjit. Në rast se Kolegji, në dhomën e këshillimit, krijon bindjen se ato janë haptazi të pabazuara, pasi nuk bëjnë pjesë në shkaqet që parashikon dispozita ligjore ose nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, atëherë është në funksionin e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore. Në kuptim të sa më sipër, jurisprudenca e Gjykatës ka ecur në linjën që një

vendim gjyqësor i dhomës së këshillimit cenon të drejtën për një proces të rregullt në ato raste kur në procesin e zhvilluar në shkallët më të ulëta të gjykimit është konstatuar cenimi i kësaj të drejte kushtetuese të individit, në një nga elementet përbërëse të saj, e cila është e vetmja e drejtë kushtetuese procedurale që i lejon individit të mbrojë të drejtat e tjera të tij substanciale. Në rast të evidentimit të një cenimi të tillë, gjatë gjykimin në shkallët e tjera, Gjykata, në zbatim të parimit të subsidiaritetit, e ka kthyer çështjen në Gjykatën e Lartë, në mënyrë që vetë ajo gjykatë, në funksion të pozicionit të saj në piramidën gjyqësore, të mund të riparojë shkeljet e kryera brenda sistemit gjyqësor. Kjo sepse Gjykata e Lartë, në funksion të rolit të saj si gjykatë e ligjit, si dhe në atë të kontrollit të respektimit të standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta, duhet të mbajë qëndrim të shprehur lidhur me pretendimet e ngritura nga individët për cenimin e një prej standardeve të procesit të rregullt, të evidentuara në gjykimin e faktit.

4. Por, në rastet kur Gjykata nuk konstaton cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në procesin gjyqësor të zhvilluar në të tria shkallët e gjykimin, ajo nuk vë në dyshim procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë, duke u mbështetur thjesht në faktin se ai ka vendosur mospranimin e rekursit në dhomë këshillimi. Ky proces është vënë në dyshim nga Gjykata vetëm në rastin kur këto vendime nuk përmbajnë shkaqet e ngritura në rekurs, çka, sipas saj, përbën cenim të parimit të arsytimit të vendimit gjyqësor. Megjithatë, edhe në lidhje me këtë parim Gjykata ka theksuar se ajo e vlerëson zbatimin e tij rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme këtë detyrim (*shih vendimin nr. 25, datë 10.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Për rrjedhojë edhe në rastin konkret në shqyrtim, shumica duhej të ishte ndalur në verifikimin e pretendimeve të ngritura nga kërkuesi dhe vetëm nëse do t'i vlerësonte ato të bazuara, atëherë duhej ta pranonte kërkesën dhe ta kthente çështjen për rishqyrtim, në mënyrë që të riparoheshin shkeljet e evidentuara në gjykimin kushtetues. Nëse Gjykata do të vazhdojë të mbajë një qasje të tillë formale, atëherë ajo do të bëhet shkak për prishjen e çdo vendimi të Gjykatës së Lartë që nuk e ka kaluar çështjen për shqyrtim në



seancë plenare vetëm me argumentin e pretendimeve me natyrë kushtetuese të ngritura në rekurs, pavarësisht nëse ato janë apo jo të bazuara, detyrë që i takon kësaj Gjykate në ushtrim të kompetencës së saj për kontrollin e respektimit të standardeve të së drejtës për një proces të rregullt ligjor nga gjykatat e zakonshme.

6. Për sa më sipër, si gjyqtar në pakicë, vlerësoj se kërkesa e paraqitur nga Eduard Banaj është e pabazuar dhe se Gjykata duhej të vendoste rrëzimin e saj.

Anëtare: Altina Xhoxhaj

MENDIM PAKICE

1. Në çështjen me kërkuar Eduard Banaj, duke qenë se jam kundër qëndrimit të shumicës, shpreh qëndrimin tim si gjyqtar në pakicë.

2. Siç është theksuar tashmë në jurisprudencën kushtetuese, në kuptim të nenit 433 të KPP-së, është në kompetencë të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) të analizojë dhe të vlerësojë nëse shkaqet e ngritura në rekurs janë në përputhje me kërkesat e ligjit. Në rast se Kolegji në dhomën e këshillimit krijon bindjen se ato janë haptazi të pabazuara, pasi nuk bëjnë pjesë në shkaqet që parashikon dispozita ligjore ose nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, atëherë është në funksionin e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore. Në këtë kuptim, Gjykata ka vënë në dyshim procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë vetëm nëse konstaton cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në procesin gjyqësor në një shkallët e gjykimit. Në këto raste në kuptim të parimit të subsidiaritetit Gjykata e ka kthyer çështjen në shqyrtim në Gjykatën e Lartë në mënyrë që ajo t'u jepte përgjigje pretendimeve me natyrë kushtetuese.

3. Në kundërshtim me sa ka vendosur shumica në këtë çështje vlerësoj se ajo duhej të ishte ndalur në vlerësimin e bazueshmërisë në themel të pretendimeve të ngritura nga kërkuari dhe vetëm në rast se do t'i gjente ato të bazuara, atëherë do të mund të vinte në dyshim procesin e zhvilluar në gjykatat e zakonshme. Nga verifikimi i pretendimeve të ngritura nga kërkuari vlerësoj se ato janë haptazi të pabazuara, siç do të argumentohet në vijim.

4. Kërkuari ka pretenduar se është cenuar parimi i ligjshmërisë në marrjen e provave, pasi i është dhënë peshë e madhe provueset deklarimit të pandehurve të tjerë në gjykim, dhe kjo ka bërë që të mos merren parasysh provat dhe faktet e tjera. Në ndryshim sa pretendon kërkuari, referuar çështjes në shqyrtim, vërehet se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier dhe ajo e Apelit Vlorë arsyetojnë se për fajësinë e kërkuarit janë bazuar jo vetëm në provat e kundërshtuara si të pavlefshme prej tij, por edhe në një sërë provash të tjera të administruara gjatë gjykimit, si provat materiale, shkresore, aktet e ekspertimit, përgjimi ambiental etj. Në këto kushte, kërkuari nuk ka arritur të paraqesë argumente të mjaftueshme përse faktet e lartpërmendura i kanë cenuar procesin nga pikëpamja kushtetuese.

5. Kërkuari ka pretenduar edhe cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë. Në vlerësimin tim edhe ky pretendim është i pabazuar, pasi nga vlerësimi në tërësi i materialeve të paraqitura nuk rezulton asnjë e dhënë e cila të tregojë se gjykatat e zakonshme që kanë shqyrtuar çështjen e kanë filluar procesin me paragjykimin se kërkuari e ka kryer veprën penale apo e kanë konsideruar të akuzuarin fajtor para dhënies së një vendimi përfundimtar për fajësinë e tij.

6. Lidhur me pretendimin tjetër të kërkuarit për cenimin e parimit të barazisë së armëve, nga materialet e dosjes gjyqësore konstatohet se kërkuari ka pasur mundësi të paraqesë pretendimet, kundërshtimet dhe provat e tij. Vetëm fakti se nuk është vendosur nga gjykatat rihetimi gjyqësor, sipas kërkesës së bërë prej tij, nuk nënkupton apriori se procesi ka qenë i parregullt. Sipas nenit 427/4 të KPP-së gjykata vendos përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor kur vërtetohet se i pandehuri nuk ka marrë pjesë në gjykimin në shkallë të parë, sepse nuk ka marrë dënim ose nuk ka mundur të paraqitet për shkaqe ligjore. Duke qenë se në rastin konkret kërkuari nuk ka provuar se ndodhej në ndonjë nga këto kushte, gjykatat nuk kishin shkak për të përsëritur hetimin gjyqësor.

7. Pavarësisht sa më sipër, pra edhe pse nuk i ka verifikuar pretendimet e kërkuarit në themel për të arritur në përfundimin nëse ato ishin ose jo të bazuara, shumica ka vlerësuar se “Gjykata, nisur nga sa më lart, arrin në përfundimin se pretendimet e paraqitura në rekursin e bërë në Gjykatën e Lartë kanë qenë të tilla që duhej të kishin marrë përgjigje nga



Kolegji Penal i asaj gjykate. Vetëm në këtë mënyrë ai kolegji do të kishte arritur në një përfundim të drejtë për të gjitha pretendimet e natyrës kushtetuese të paraqitura nga kërkuesi, i cili do të kishte mundur të realizonte efektivisht të drejtën e aksesit në gjykatë” (sibih paragrafin 18 të vendimit).

8. Duke mbajtur një qëndrim të tillë Gjykata e zhvesh dhomën e këshillimit nga kompetencat që i janë njohur asaj sipas dispozitave procedurale përkatëse, kompetenca që edhe në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se janë në përputhje me funksionin e saj si gjykatë e ligjit.

9. Për të gjitha argumentet e mësipërme vlerësoj se kërkesa e paraqitur nga Eduard Banaj është e pabazuar dhe se ajo nuk duhej të pranohej nga Gjykata.

Anëtare: Vitore Tusha

VENDIM
Nr. 65, datë 16.10.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“

me sekretare Belma Lleshi, në datën 26.9.2017, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 40 akti që i përket:

KËRKUES: Petrit Muçaj, Ervehe Muçaj, Liljana Muçaj

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Prokuroria e Krimeve të Rënda

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimeve nr. 1258, datë 20.5.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. 1328, datë 15.7.2015, të Gjykatës së Apelit Tiranë, nr. 00-2017-305, datë 7.4.2017, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4/1, 5, 42, 131/1/f, 134/ 1/i dhe 134/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6/1 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Gani Dizdari, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuesve, që u shprehën për pranimin e kërkesës, parashtrimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Krimeve të Rënda, që u shpreh për rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Prokuroria panë Gjykatës së Krimeve të Rënda, në datën 4.5.2015, bazuar në ligjin nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, ka filluar procedimin pasuror nr. 5 ndaj kërkuesve: Petrit Muçaj, Ervehe Muçaj dhe Liljana Thomai (Muçaj), si persona të lidhur me shtetasin Fatmir Muçaj. Ky i fundit është hetuar dhe gjykuar për kryerjen e veprës penale të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve dhe pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale.

2. Gjykata e Krimeve të Rënda, me vendimin nr. 24, datë 30.11.2016, ka vendosur: “*Konfiskimin e disa pasurive të kërkuesve, sipas vendimit.*”.

3. Gjykata e Apelit të Krimeve të Rënda, me vendimin nr. 8, datë 19.1.2017, ka vendosur: “*Ndryshimin e vendimit të mësipërm vetëm për një pasuri të ndodhur në zonën kadastrale Yzberisht. Lënien në fuqi të vendimit nr. 24, datë 30.11.2016, të Gjykatës së Krimeve të Rënda për pjesën tjetër.*”.

4. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2017-305, datë 7.4.2017, në dhomë këshillimi ka vendosur: “*Mospranimin e rekursit pasi nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 472 i Kodit të Procedurës Civile.*”.



II

5. **Kërkuesit** i janë drejtuar Gjykatës me kërkesë për shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Penal, duke pretenduar se ai është rrjedhojë e një procesi jo të rregullt ligjor. Ata kanë parashtruar, në mënyrë të përmbledhur, këto shkaqe:

5.1 Gjykatat kanë cenuar të drejtën e pronës duke e konfiskuar atë nëpërmjet një procesi civil para Gjykatës së Krimeve të Rënda. Vepra penale e kryer nga shtetasi Fatmir Muçaj, si person i lidhur me kërkuesit, është një ngjarje e cila ka ndodhur në të shkuarën dhe nuk mund të dënohen në vazhdimësi persona të tjerë për shkak të tij.

5.2 Gjykatat nuk kanë marrë parasysh vlerësimet e ekspertëve, duke konkluduar se pasuritë që disponojnë nuk justifikohen me të ardhurat që kanë fituar në vite. Gjykatat kanë cenuar parimin e kontradiktoritetit, pasi nuk kanë marrë parasysh disa nga provat e paraqitura, si kredi bankare në Itali apo pensione të përfituara nga bashkëshortët.

5.3 Gjykimi në shkallë të parë është bërë në mungesë të kërkuesve, duke mos u dhënë atyre mundësi të shprehën gjatë gjykimit.

5.4 Vendimi i Kolegjit Penal është i paarsyetuar dhe ka cenuar të drejtën e aksesit në gjykatë. Ai kolegji nuk pranoi të merrte në shqyrtim në seancë pretendimet e ngritura, të cilat ishin tërësisht në rrethin e atyre çështjeve që parashikon neni 472 i KPC-së.

6. **Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme**, parashtrroi me shkrim si më poshtë:

6.1 Është i pabazuar pretendimi se gjykatat nuk kanë respektuar parimin e barazisë së armëve. Ky parim nuk nënkupton që gjykatat duhet të marrin si të bazuar çdo lloj akti ose prove që paraqesin palët në gjykim. Është në kompetencë të gjykatës të vlerësojë se cila prej provave është apo jo e ligjshme dhe që i shërben gjykimit të drejtë të çështjes.

6.2 Është i pabazuar edhe pretendimi se kërkuesit nuk janë dëgjuar dhe mbrojtur gjatë gjykimit. Referuar dosjes gjyqësore, gjykatat kanë marrë të gjitha masat për të njoftuar kërkuesit dhe vetëm pasi është vërtetuar se ata nuk gjenden në territorin e Republikës së Shqipërisë, është bërë caktimi i avokatëve kryesisht për secilin prej

kërkuesve, me qëllim përfaqësimin ligjor të tyre sipas rregullave procedurale për këtë qëllim.

6.3 Nuk është i bazuar as pretendimi se vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është i paarsyetuar. Çështja është shqyrtuar në dhomën e këshillimit si filtër seleksionues dhe ai vendim i plotëson të gjitha standardet e arsyetimit të vendimit në këtë fazë shqyrtimi, referuar edhe jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese për këtë qëllim.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesve

7. Kërkuesit legjitimohen *ratione personae*, në kuptim të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës dhe *ratione temporis*, pasi pretendimet e tyre janë paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar. Gjithashtu, ata legjitimohen edhe *ratione materiae*, pasi pretendimet e ngritura bëjnë pjesë në rrethin e çështjeve që mund të shqyrtohet nga kjo Gjykatë. Kërkuesit nuk kanë mjet tjetër në dispozicion përveç ankimit para kësaj Gjykate. Në këto kushte, ata legjitimohen në kërkimet e tyre.

B. Për pretendimin e cenimit të procesit të rregullt nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë

8. Sipas kërkuesve, gjykimi në shkallë të parë është zhvilluar në mungesë të tyre. Pavarësisht se gjykata ka caktuar avokat kryesisht për mbrojtjen e tyre, e drejta e tyre për të marrë pjesë dhe për t’u dëgjuar e mbrojtur personalisht para gjykatës ka mbetur e porealizuar efektivisht. Gjykatat nuk kanë respektuar parimin e kontradiktoritetit gjatë gjykimit, duke mos marrë parasysh faktet e provat e paraqitura prej tyre, por vetëm të prokurorisë. Gjithashtu, kërkuesit kanë pretenduar se Kolegji Penal ka cenuar standardin e arsyetimit dhe të aksesit në gjykatë, duke mos e kaluar çështjen në gjykim, megjithëse pretendimet e ngritura në rekurs ishin të tilla që duhej të shqyrtoheshin në seancë gjyqësore me praninë e palëve.

9. Në nenin 42/2 të Kushtetutës parashikohet se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë ka të



drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Kjo dispozitë sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Në rast se mohohet kjo e drejtë, procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës (*shih vendimet nr. 21, datë 20.3.2017; nr. 52, datë 14.11.2014, të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Gjithashtu, Gjykata ka vlerësuar se neni 42 i Kushtetutës sanksionon në vetvete jo vetëm të drejtën e individit për t'iu drejtuar gjykatës, por edhe detyrimin e shtetit që t'ia garantojë atij këtë akses. Gjykata ka konsideruar se sipas këtij neni detyrimi për të garantuar të drejtën efektive të aksesit në gjykatë nuk nënkupton thjesht mungesën e një ndërhyrjeje, por mund të kërkojë edhe ndërmarrjen e veprimeve pozitive nga ana e shtetit. Në rast se mohohet një e drejtë e tillë, procesi konsiderohet jo i rregullt, sepse aksesit në gjykatë është para së gjithash një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës (*shih vendimet nr. 84, datë 30.12.2016; nr. 67, datë 17.11.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në këtë këndvështrim, Gjykata ka vlerësuar se Gjykata e Lartë, rast pas rasti, duhet t'u japë përgjigje problemeve ligjore, që në

praktikë lidhen me interpretimin e ligjit. Sipas Gjykatës, në të tilla raste kërkesit, duke mos marrë përgjigje për pretendimet e tij me natyrë kushtetuese, për shkak të vendimit të mospranimit të rekursit, i cenohet jo vetëm e drejta e aksesit, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, por edhe e drejta e ankimit në kuptimin substancial, e parashikuar në nenin 43 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 27, datë 27.3.2017; nr. 73, datë 16.12.2016; nr. 24, datë 25.4.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Gjykata është shprehur se përdorimi i mjetit procedural të përshtatshëm ankimes në formë e në përmbajtje, siç është sanksionuar në Kodin e Procedurës Penale, nuk përbën një kërkesë formale, por një kërkesë që lidhet me thelbin e së drejtës së mbrojtjes dhe të pjesëmarrjes aktive në gjykim. Mostrajtimi i mjetit procedural në mënyrë substanciale cenon të drejtën e mbrojtjes së të gjykuarit dhe njëkohësisht aksesin e tij në Gjykatën e Lartë (*shih vendimet nr. 84, datë 30.12.2016; nr. 21, datë 24.7.2006, të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Gjykata në këtë drejtim ka theksuar se është kompetencë e Kolegjit Civil/Penal (dhoma e këshillimit) të analizojë dhe vlerësojë nëse shkaqet e ngritura në rekurs janë në përputhje me kërkesat e ligjit. Megjithatë, ky standard nuk duhet kuptuar sikur i mundëson Gjykatës së Lartë ushtrimin e kompetencës së mësipërme në mënyrë diskrecionale. Gjykata ka theksuar se standardet kushtetuese për një proces të rregullt ligjor duhen respektuar në të gjitha fazat e gjykimit, përfshirë këtu shqyrtimin e rekursit nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit. Rekursi është mjeti procedural në dispozicion të kërkesit, me anë të të cilit ai mund të ketë akses në Gjykatën e Lartë, duke e investuar këtë të fundit me shqyrtimin e pretendimeve të tij (*shih vendimet nr. 73, datë 16.12.2016; nr. 24, datë 25.4.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Referuar jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, Gjykata e Lartë, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë ligji, ka për detyrë të kontrollojë mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta (*shih vendimet nr. 84, datë 30.12.2016; nr. 14, datë 17.4.2007; nr. 35, datë 20.12.2005, të Gjykatës Kushtetuese*). Po ashtu, Gjykata, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave



individuale, ka tashmë një qëndrim të konsoliduar, sipas të cilit kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Një linjë e tillë lidhur me raportin ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/1/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit) (*shih vendimet nr. 4, datë 28.2.2006; nr. 19, datë 2.4.2012; nr. 58, datë 24.12.2012; nr. 52, datë 2.12.2013; nr. 3, datë 23.1.2014; nr. 84, datë 30.12.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Për sa u takon vendimeve të dhëna nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit dhe referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, Gjykata ka theksuar se vetëm kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, vendimi i Kolegjit për mospranimin e rekursit vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 19, datë 19.7.2005; nr. 22, datë 6.6.2011; nr. 18, datë 14.4.2015; nr. 84, datë 30.12.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Duke iu rikthyer çështjes konkrete, Gjykata vëren se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit me argumentin se nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 432 i KPP-së. Po ashtu, Gjykata konstaton se kërkesit, në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë, kanë ngritur pretendime të natyrës kushtetuese. Konkretisht, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkesve se gjykimi është zhvilluar në mungesë, pasi nuk kanë pasur njoftim, është i tillë që duhet të ishte shqyrtuar nga Kolegji Penal, me qëllim që ai kolegji të vlerësonte nëse pretendimet e tyre ishin apo jo të bazuara, duke qenë se të paktën për njërin prej kërkesve (Liljana Muçaj) verifikimi i marrjes apo jo të njoftimit nuk është kryer nga gjykatat. Pretendimi për konfiskimin ose jo të një pasurie bashkëshortore pa u thirrur të dy bashkëpronarët i ka vënë në pamundësi kërkesit për të realizuar të drejtën e tyre për t'u dëgjuar dhe si rrjedhojë edhe të drejtën për akses efektiv në gjykatë.

Gjithashtu, në rekurs janë ngritur edhe pretendimet të tjera të natyrës kushtetuese, të tilla si mosrespektimi i parimit të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve në gjykim, duke hedhur poshtë aktin e ekspertimit të paraqitur nga kërkesit pa dhënë argumente nga ana e gjykatës etj. Gjykata çmon se Kolegji Penal, bazuar në pretendimet e parashtruara në rekurs dhe argumentet e sjella, duhej ta kishte vlerësuar bazueshmërinë e tyre në praninë e palëve dhe jo në mungesë të tyre, duke dhënë në përfundim një vendim të arsyetuar për të gjitha pretendimet e kërkesve. Vetëm në këtë mënyrë do të garantohej e drejta e kërkesve për akses efektiv në gjykatë, sipas standardeve të vendosura tashmë nga jurisprudenca kushtetuese.

17. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkesve për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor nga ana e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, është i bazuar dhe duhet pranuar.

C. Për pretendimet e tjera

18. Për sa u takon pretendimeve të tjera të kërkesve, që kanë të bëjnë me kërkesën për cenim të së drejtës së pronës, mënyrën e vlerësimit të pasurive, kontradiktoritetit në gjykim, cenimin e së drejtës së mbrojtjes, si dhe parimin e arsytimit të vendimeve gjyqësore, Gjykata vlerëson të mos ndalet në analizimin e tyre, për sa kohë çështja do të merret përsëri në shqyrtim nga Gjykata e Lartë, e cila në funksion të rolit të saj si gjykatë e ligjit dhe si kontrolluese e respektimit të standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta duhet t'u japë përgjigje të arsyetuar pretendimeve të mësipërme të ngritura në rekurs.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 71 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës.
- Shfuqizimin si të papajtuësëm me Kushtetutën të vendimit nr. 00-2017-305, datë 7.4.2017, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.



- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar),
Besnik Imeraj, Fatmir Hoxha, Gani Dizdari,
Fatos Lulo

Anëtarë kundër: Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha

MENDIM PAKICE

1. Në çështjen me kërkuar Petrit Muçaj etj., jam kundër qëndrimit të shumicës për pranimin pjesërisht të kërkesës, duke shfuqizuar si të papajtueshëm me Kushtetutën vendimin nr. 00-2017-305, datë 7.4.2017, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

2. Sipas shumicës, në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë, kërkuar kanë ngritur pretendime të natyrës kushtetuese, më konkretisht se gjykimi është zhvilluar në mungesë, sepse ata nuk janë njoftuar për gjykimin, se nuk është respektuar parimi i kontradiktoritetit dhe i barazisë së armëve në gjykim etj. Sipas shumicës, Kolegji Penal, bazuar në pretendimet e parashtruara në rekurs dhe argumentet e sjella, duhej ta kishte vlerësuar bazueshmërinë e tyre në seancë dhe jo në dhomë këshillimi dhe ai duhej të kishte dhënë një vendim të arsyetuar për pretendimet e kërkuarëve, pasi vetëm në këtë mënyrë do të garantohej e drejta e tyre për akses efektiv në gjykatë.

3. Në jurisprudencë konstante, Gjykata ka theksuar se, bazuar në nenin 433 të KPP-së, është në kompetencë të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) të analizojë dhe të vlerësojë nëse shkaqet e ngritura në rekurs janë në përputhje me kërkesat e ligjit. Në rast se Kolegji, në dhomën e këshillimit, krijon bindjen se ato janë haptazi të pabazuara, pasi nuk bëjnë pjesë në shkaqet që parashikon dispozita ligjore ose nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, atëherë është në funksionin e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore.

4. Megjithatë, Gjykata ka theksuar se kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me

shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, atëherë vendimi i Kolegjit, për mospranimin e rekursit, vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 19, datë 19.7.2005; nr. 22, datë 6.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*). Kjo sepse, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Ky raport midis juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/1/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit) (*shih vendimin nr. 52, datë 2.12.2013, të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Në kuptim të sa më sipër, jurisprudenca e Gjykatës ka ecur në linjën që një vendim gjyqësor i dhomës së këshillimit cenon të drejtën për një proces të rregullt në ato raste kur në procesin e zhvilluar në shkallët më të ulëta të gjykimit është konstatuar cenimi i kësaj të drejte kushtetuese të individit, në një nga elementet përbërëse të saj, e cila është e vetmja e drejtë kushtetuese procedurale që i lejon individit të mbrojë të drejtat e tjera të tij substanciale. Në rast të evidentimit të një cenimi të tillë, gjatë gjykimit në shkallët e tjera, Gjykata, në zbatim të parimit të subsidiaritetit, e ka kthyer çështjen në Gjykatën e Lartë, në mënyrë që vetë ajo gjykatë, në funksion të pozicionit të saj në piramidën gjyqësore, të mund të riparojë shkeljet e kryera brenda sistemit gjyqësor. Kjo sepse Gjykata e Lartë, në funksion të rolit të saj si gjykatë e ligjit, si dhe në atë të kontrollit të respektimit të standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta, duhet të mbajë qëndrim të shprehur lidhur me pretendimet e ngritura nga individët për cenimin e një prej standardeve të procesit të rregullt, të evidentuara në gjykimin e faktit.

6. Por, në rastet kur Gjykata nuk konstaton cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në procesin gjyqësor të zhvilluar në të tria shkallët e gjykimit, ajo nuk vë në dyshim procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë, duke u mbështetur thjesht në faktin se ai ka vendosur mospranimin e rekursit në dhomë këshillimi. Ky proces është vënë në dyshim nga Gjykata vetëm



në rastin kur këto vendime nuk përmbajnë shkaqet e ngritura në rekurs, çka, sipas saj, përbën cenim të parimit të arsytimit të vendimit gjyqësor. Megjithatë, edhe në lidhje me këtë parim, Gjykata ka theksuar se ajo e vlerëson zbatimin e tij rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme këtë detyrim (*shih vendimin nr. 25, datë 10.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Në rastin konkret në shqyrtim, vlerësoj se shumica duhej të ishte ndalur në verifikimin e pretendimeve të ngritura nga kërkuesit dhe vetëm nëse do i vlerësonte ato të bazuara, atëherë duhej ta pranonte kërkesën dhe ta kthente çështjen për rishqyrtim, në mënyrë që të riparoheshin shkeljet e evidentuara në gjykimin kushtetues. Nëse Gjykata do të vazhdojë të mbajë një qasje të tillë formale, atëherë ajo do të bëhet shkak për prishjen e çdo vendimi të Gjykatës së Lartë që nuk e ka kaluar çështjen për shqyrtim në seancë plenare vetëm me argumentin e pretendimeve me natyrë kushtetuese të ngritura në rekurs, pavarësisht nëse ato janë apo jo të bazuara, detyrë që i takon kësaj Gjykate në ushtrim të kompetencës së saj për kontrollin e respektimit të standardeve të së drejtës për një proces të rregullt ligjor nga gjykatat e zakonshme.

8. Megjithatë, duke i vlerësuar në themel pretendimet e kërkuesve, vlerësoj se ato janë të pabazuara. Në lidhje me pretendimin e cenimit të së drejtës për t'u mbrojtur dhe parimit të barazisë së armëve në gjykim, sipas materialeve të çështjes rezulton se seanca e parë gjyqësore para Gjykatës së Krimeve të Rënda është caktuar në datën 1.12.2015, duke bërë edhe njoftimet përkatëse për kërkuesit dhe Prokurorinë e Krimeve të Rënda. Në vijim, në të gjitha seancat e mëpasshme, ka rezultuar se kërkuesit nuk gjendeshin në vendbanimet e deklaruara në fashikullin e hetimit dhe të gjykimit. Për këtë arsye, gjykata ka vendosur shtyrjen e gjykimit disa herë, konkretisht në datat 18.12.2015, 28.12.2015, 15.1.2016, 29.1.2016 dhe 12.2.2016. Gjatë secilës prej këtyre seancave, gjykata ka marrë të gjitha masat për të vërtetuar nëse kërkuesit janë apo jo të pranishëm dhe kanë marrë ose jo njoftim vetë ose nëpërmjet familjarëve.

9. Nga ana e gjykatës është urdhëruar edhe kryerja e hetimeve/kërkimeve nga punonjësit e Policisë së Shtetit, të cilët kanë verifikuar në adresat zyrtare të kërkuesve nëse banojnë apo jo në to. Gjithashtu janë administruar edhe procesverbalet e sistemit elektronik të hyrjeve dhe daljeve nga territori i Republikës së Shqipërisë (TIIMS). Vetëm pasi kanë rezultuar të pasuksesshme të gjitha përpjekjet e gjykatës për të njoftuar personalisht kërkuesit, është bërë njoftimi me shpallje, sipas rregullave procedurale për këtë qëllim. Po ashtu, rezulton se gjykatat kanë marrë masat për të caktuar mbrojtës kryesisht për kërkuesit, konform rregullave, në seancën e datës 12.2.2016. Më tej, pas disa shtyrjesh për shkak të mungesave të ndonjërit prej avokatëve të kërkuesve apo prokurorit të çështjes, seanca e parë e gjykimit të çështjes në themel është zhvilluar në datën 31.3.2016 e në vijim. Referuar dosjes gjyqësore dhe procesverbaleve të mbajtura gjatë seancave të gjykimit konstatohet se avokatët e caktuar kryesisht kanë kryer rregullisht veprime në favor të kërkuesve që përfaqësonin. Më tej, në seancën e datës 8.7.2016, dy prej kërkuesve, Petrit Muçaj dhe Ervehe Muçaj, kanë paraqitur me anë të prokurës së hartuar prej tyre që të përfaqësohen prej avokatit të zgjedhur prej tyre me prokurë Ardian Visha. Prej këtij momenti, ata rezultojnë të kenë marrë pjesë dhe të jenë mbrojtur efektivisht prej këtij avokati të zgjedhur. Ndërsa për kërkuesen Liljana Muçaj përfaqësimi ka vijuar të bëhet nga avokati i caktuar kryesisht. Megjithatë, referuar procesverbalit të dosjes gjyqësore rezulton se në seancën e datës 27.7.2016 avokati i Liljana Muçaj ka deklaruar se *“kam pasur kontakt me të paditurën Liljana Muçaj dhe nga ana e saj është dërguar një kopje me të ardhurat e saj ndër vite...”* (shih fq. 129-130 të fashikullit nr.1 të dosjes gjyqësore). Nisur nga kjo deklaratë e administruar në dosje rezulton se edhe kërkuesja Liljana Muçaj ka qenë në dijeni të zhvillimit të procesit gjyqësor dhe ka zgjedhur me vullnetin e saj të përfaqësohet nga avokati i caktuar kryesisht nga gjykata. Në këto kushte nuk ka asnjë bazë të arsyeshme për të dyshuar në mosrealizimin e mbrojtjes efektive gjatë gjykimit dhe për rrjedhojë ky pretendim është i pabazuar.

10. I pabazuar është edhe pretendimi i kërkuesve për cenimin e së drejtës së aksesit dhe



parimit të arsytimit të vendimit gjyqësor nga ana e Kolegjit Penal, për shkak të moskalimit të çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore. Bazuar edhe në standardet e evidentuara më sipër, shqyrtimi paraprak vlerësues nëse rekursi plotëson ose jo kushtet për kalimin e tij për shqyrtim në seancë gjyqësore është kompetencë vetëm e trupës së gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi dhe nuk mund të bëhet pjesë e kontrollit kushtetues që zhvillon Gjykata (*sbih vendimet nr. 21, datë 20.3.2017; nr. 8, datë 26.2.2015, të Gjykatës Kushtetuese*). Kurse për sa i takon arsytimit të këtyre vendimeve është theksuar edhe nga GJEDNJ-ja se arsytimi i kufizuar i dhënë nga Gjykata e Lartë në formulimin e vendimit në dhomë këshillimi, në mënyrë të nënkuptuar evidenton se aplikanti nuk ka ngritur një nga argumentet ligjore të përcaktuara në dispozitën përkatëse të legjislacionit të brendshëm, që është kusht për pranimin e kërkesës. Gjykata vëren se kur një gjykatë e lartë refuzon të pranojë një çështje, për arsye se mungojnë shkaqet ligjore për ngritjen e çështjes, një arsytim shumë i kufizuar mund të përmbushë kriterin e nenit 6 të Konventës (*Marini kundër Shqipërisë, datë 18.12.2007, §105-106; Mishgjoni kundër Shqipërisë, datë 07.12.2010, § 51*). Për rrjedhojë, edhe në rastin konkret Gjykata e Lartë ka vepruar në përputhje me kompetencat e saj ligjore dhe vendimi nuk cenon standardin e arsytimit.

11. Për sa më sipër, si gjyqtar në pakicë, vlerësoj se edhe në thelb pretendimet e kërkuarve janë të pabazuara dhe se Gjykata duhej të vendoste rrëzimin e kërkesës.

Anëtare: Altina Xhoxhaj

MENDIM PAKICE

1. Në çështjen me kërkuar Petrit Muçaj, Ervehe Muçaj dhe Liljana Muçaj, duke qenë se jam kundër qëndrimit të shumicës, shpreh qëndrimin tim si gjyqtar në pakicë.

2. Siç është theksuar tashmë në jurisprudencën kushtetuese, në kuptim të nenit 433 të KPP-së, është në kompetencë të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) të analizojë dhe të vlerësojë nëse shkaqet e ngritura në rekurs janë në përputhje me kërkesat e ligjit. Në rast se Kolegji në dhomën e këshillimit krijon bindjen se ato janë haptazi të pabazuara, pasi nuk bëjnë pjesë në shkaqet që parashikon dispozita ligjore ose nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, atëherë është në funksionin e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore. Në këtë kuptim, Gjykata Kushtetuese ka vënë në dyshim procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë vetëm nëse konstaton cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në procesin gjyqësor në një nga shkallët e gjykimit. Në këto raste, në kuptim të parimit të subsidiaritetit Gjykata e ka kthyer çështjen në shqyrtim në Gjykatën e Lartë në mënyrë që kjo e fundit t'u japë përgjigje pretendimeve me natyrë kushtetuese.

3. Në kundërshtim me sa ka vendosur shumica në këtë çështje vlerësoj se ajo duhej të ishte ndalur në vlerësimin e bazueshmërisë në themel të pretendimeve të ngritura nga kërkuar dhe vetëm në rast se do të kishte dyshime në lidhje me respektimin e standardeve kushtetuese, atëherë do të vendoste shfuqizimin e vendimeve të kundërshtuara.

4. Sipas kërkuarve, gjykimi në shkallë të parë është zhvilluar në mungesë të tyre dhe pavarësisht se gjykata ka caktuar avokat kryesisht për mbrojtjen e tyre, e drejta e tyre për të marrë pjesë dhe për t'u dëgjuar e mbrojtur personalisht para gjykatës ka mbetur e pabaralizuar efektivisht. Po ashtu, ata kanë pretenduar se gjykatat nuk kanë respektuar parimin e kontradiktoritetit gjatë gjykimit, duke mos marrë parasysh faktet e provat e paraqitura prej tyre, por vetëm të prokurorisë.



5. Nga materialet e kësaj çështjeje rezultojnë se në seancat gjyqësore të zhvilluar në Gjykatën e Krimeve të Rënda janë marrë të gjitha masat për njoftimin e kërkuesve në respektim të dispozitave procedurale penale. Nga ana e gjykatës është urdhëruar edhe kryerja e hetimeve/kërkimeve nga punonjësit e Policisë së Shtetit, si dhe janë administruar edhe procesverbalet e prodhuara nga sistemi TIMS. Vetëm pasi kanë rezultuar të pasuksesshme të gjitha përpjekjet e gjykatës për të njoftuar personalisht kërkuesit, është bërë njoftimi me shpallje, sipas rregullave procedurale për këtë qëllim. Pavarësisht se kërkuesit kanë qenë në mungesë, gjykata ka marrë të gjitha masat për t'u garantuar atyre të drejtën e mbrojtjes, duke u caktuar mbrojtës kryesisht, të cilët po ashtu rezultojnë se kanë kryer një mbrojtje efektive. Rezultojnë gjithashtu se në seancën e datës 8.7.2016 është paraqitur mbrojtësi i zgjedhur me prokurorë prej kërkuesve Petrit Muçaj dhe Ervehe Muçaj, dhe gjykimi ka vijuar në prani të tij. Po ashtu, rezultojnë se për kërkuesen Liljana Muçaj mbrojtja është realizuar nga avokati i caktuar kryesisht, i cili në seancën e datës 27.7.2016 ka deklaruar se ka pasur kontakt me të. Bazuar në këto fakte rezultojnë se kërkuesit jo vetëm që kanë marrë dijeni për procesin, por atyre u është garantuar edhe e drejta e mbrojtjes në gjykim. Këto pretendime me natyrë kushtetuese, që lidhen me të drejtën për t'u thirrur e dëgjuar, u verifikuan në gjykimin e zhvilluar në këtë Gjykatë dhe ato rezultuan të pabazuara. Në këtë kuptim është i pavend dhe i pakuptimtë kthimi i çështjes për rishqyrtim. Për sa kohë që nuk ka dyshime për cenimin e këtyre standardeve, Gjykata duhet të kishte vendosur rrëzimin e kërkesës.

6. Pavarësisht sa më sipër, shumica ka vlerësuar: *“Po ashtu, Gjykata konstaton se kërkuesit, në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë, kanë ngritur pretendime të natyrës kushtetuese. Konkretisht, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesve se gjykimi*

është zhvilluar në mungesë, pasi nuk kanë pasur njoftim, është i tillë që duhet të ishte shqyrtuar nga Kolegji Penal, me qëllim që ai kolegji të vlerësonte nëse pretendimet e tyre ishin apo jo të bazuara, duke qenë se të paktën për njërin prej kërkuesve (Liljana Muçaj) verifikimi i marrjes apo jo të njoftimit nuk është kryer nga gjykatat. Pretendimi për konfiskimin ose jo të një pasurie bashkëshortore pa u thirrur të dy bashkëpronarët i ka vënë në pamundësi kërkuesit për të realizuar të drejtën e tyre për t'u dëgjuar dhe si rrjedhojë edhe të drejtën për akses efektiv në gjykatë. Gjithashtu, në rekurs janë ngritur edhe pretendimet të tjera të natyrës kushtetuese, të tilla si mosrespektimi i parimit të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve në gjykim, duke hedhur poshtë aktin e ekspertimit të paraqitur nga kërkuesit pa dhënë argumente nga ana e gjykatës etj. Gjykata çmon se Kolegji Penal, bazuar në pretendimet e parashtruara në rekurs dhe argumentet e sjella, duhet ta kishte vlerësuar bazueshmërinë e tyre në praninë e palëve dhe jo në mungesë të tyre, duke dhënë në përfundim një vendim të arsyetuar për të gjitha pretendimet e kërkuesve. Vetëm në këtë mënyrë do të garantohet e drejta e kërkuesve për akses efektiv në gjykatë, sipas standardeve të vendosura tashmë nga jurisprudenca kushtetuese.”

7. Vlerësoj se duke mbajtur një qëndrim të tillë për shqyrtimin e pretendimeve të kërkuesve në praninë e tyre, çka nënkupton se Kolegji Penal duhet ta kalojë tashmë çështjen e kthyer për rishqyrtim në seancë gjyqësore, Gjykata e ka zhveshur dhomën e këshillimit nga kompetencat që i janë njohur asaj sipas dispozitave procedurale përkatëse, kompetenca që edhe në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se janë në përputhje me funksionin e saj si gjykatë e ligjit.

8. Për të gjitha argumentet e mësipërme vlerësoj se kërkesa e paraqitur nga kërkuesit Petrit Muçaj, Ervehe Muçaj dhe Liljana Muçaj është e pabazuar dhe se ajo nuk duhet të pranohet nga Gjykata.

Anëtare: Vitore Tusha

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa: Rr "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel/fax +355 4 24 27 004 Tel +355 4 24 27 006

Çmimi 140 lekë